



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 07 Tetor 2021

Nr: 459

VENDIM

PËR

DEKLARIMIN TË PËRFUNDUAR DHE PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË SHQYRTIMIT TË REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. IDO MUHARREM PASHAJ, KANDIDAT PËR DEPUTET I PROPOZUAR NGA KOALICIONI ALEANCA BASHKIMI POPULLOR-EMIGRACIONI-ORA E SHPRESËS DHE KONSERVATORËT (ABEOK), QARKU FIER, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”

Sot më datë 07.10.2021, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Ido Muharrem Pashaj, kandidat për deputet i propozuar nga Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), qarku Fier, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

Palë të interesuara: Z. Ido Muharrem Pashaj, kandidat për deputet i listës shumëmemërore të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.



Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati për deputet”.

Në zbatim të këtyre dispozitave", z. Ido Muharrem Pashaj, kandidat për deputet i propozuar nga Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), qarku Fier, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetdeklarimit me numër unik 068.

Përpara miratimit të listave të kandidatëve për deputetë për subjektin zgjedhor Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), në bazë të kompetencave të veta, KQZ bëri verifikimin prima facie dhe konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, dhe ndërmoi hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2204 prot., datë 17.03.2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 2858/1 prot., datë 18.03.2021 informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për deputet, z. Ido Muharrem Pashaj, rezulton i dënuar. Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore



nr. 07, datë 18.03.2021 bashkëlidhur përgjigjes, z. Ido Muharrem Pashaj, rezulton i dënuar dhe në bazë të nenit 69 të Kodit Penal është rehabilituar.

- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2212 prot., datë 17.03.2021, ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 2212/1 prot., datë 09.04.2021, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për deputet z. Ido Muharrem Pashaj, rezulton të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.
- c. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 167 datë 18.03.2021, vendosi “Miratimin e listave shumëmemërore të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”.

II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet z. Ido Muharrem Pashaj.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Ido Muharrem Pashaj, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenealitete të mëparshme” të formularit të vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjenealitetet e tij dhe është shprehur se, ka ndryshuar emrin nga “Xhevdet” në “Ido”.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pyetjes 1, “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se: Gjykata e Vlorës e ka dënuar me 6 vite burgim për veprën penale “Agjitacion dhe propagandë”, parashikuar nga neni 55 i Kodit Penal.

Pyetjes 3, “A keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:



Në vitet 1997-1999 është dënuar me 21 muaj burgim nga Gjykata e Triestes, Itali për veprën penalë të “Rrahjes”.

Pyetjes 4, “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e ndonjë vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se: Nga Gjykata e Vlorës është dënuar me burgim në vitet 1986-1991, për arsye politike.

Pyetjes 5, “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se: Është caktuar masë shtrënguese e sigurisë, ndalim i daljes jashtë shtetit, masë e cila është aktualisht në fuqi.

Pyetjes 7, “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se: Në vitin 2018, është dëbuar nga Portenone, Itali për arsye dokumentacioni.

Pyetjes 8, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se: Në vitin 1991-2018 ka jetuar në Sandona di Piave, Venecia, Itali për arsye emigracioni.

Duke analizuar përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe deklarimet e vetë subjektit në formular, sipas të cilave ai pohon se ka qënë i proceduar nga Policia Italiane, bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në Kreun V, pika 2, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2588 prot., datë 24.03.2021 vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 539/57 prot., datë 27.09.2021, të administruar nga KQZ-ja me nr. 2588/1 prot., datë 27.09.2021, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Ido Muharrem Pashaj”.



Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve të mundshme brenda dhe jashtë vendit, i konsideron këto verifikime të plota bazuar në përcaktimet e nenit 8, pikat 1 dhe 2 të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 ka miratuar rezultatin e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Ido Muharrem Pashaj sipas të cilit konstatohet:

- Rezulton të ketë ndryshuar më datë 03.10.2011 përberësin e gjendjes civile, rubrikën e emrit nga "Xhevdet" në "Ido".
- Rezulton të ketë përdorur gjatë qëndrimit të tij në Itali dhe disa emra të tjerë që janë:
 - Maumet SABA, i lindur me 15.08.1962 në Marok;
 - Zdravkos JSLAMI, i lindur më 15.08.1958 në Jugosllavi;
 - Mauren SALI, i lindur më 15.08.1959 në Marok;
 - Sdravkos JSLAMI, i lindur më 15.08.1959 në Jugosllavi.
- Rezulton të jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë nga:
 - a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 10, datë 12.01.1977, e ka dënuar me 1 (një) vit burgim, për kryerjen e veprës penale “Përvetësim të pasurisë private”, në bazë të nenit 182/2 e 46 të Kodit Penal, lënë në fuqi me vendimin nr.8 datë 24.01.1977 nga Gjykata e Apelit;
 - b. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 178, datë 02.11.1984, e ka dënuar me 10 (dhjetë) muaj riedukim nëpërmjet punës me ndalesë 1/5 e pagës, për kryerjen e veprës penale “Plagosje të lehtë me dashje”, në bazë të nenit 93/1 rë e 31/ A të Kodit Penal;
 - c. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, vendimit nr. 28, datë 25.02.1988, e ka dënuar me 6 (gjashtë) vjet heqje lirie, për krimin e agjitacionit dhe propogandës kundër shtetit, në bazë të nenit 55/1 dhe 31/a të Kodit Penal;
 - d. Gjykata e Apelit të Triestes, Seksioni i II Penal, me vendimin n. 352/2013, datë 07.03.2013, me 2 (dy) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burg, për krimin kërcënimit serioz të kryer në mënyrë vazhduese nga viti 2006, në bazë të nenit 81 parag.2, dhe nenit 612 parag.2, të KP (Italian);Ky krim konvertohet si vepra penale "Kanosja" të parashikuar nga nenet 84 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Dënim i dhënë nga gjykata italiane rezulton se nuk është kryer. Masa

e dënimit është urdhëruar për zbatim, nëse personi i dënuar rihyn në mënyrë të paligjshme në territorin e Shtetit, para afatit 5 vjetësh nga ekzekutimi i dëbimit.

e. Gjykata e Zakonshme e Pordenone/ ITALI, me vendimin nr. 607/2018, R.G.563/2018-R.G.N.R. n. 2424/2018, datë 04.07.2018, e ka dënuar me 1 (një) vit e 3 (tre) muaj burg dhe 300,00 Euro gjobë, për veprën penale të vjedhjes, në bazë të nenit 628 parag.2 K.P., të zëvendësuar me sanksion alternativ të dëbimit për një periudhë 10 vjeçare nga teritori i shtetit Italian, në bazë të nenit 16 paragrafi i I-rë i Dekretit legjislativ 286/98.

Ky krim konvertohet si vepra penale e vjedhjes së kryer më shumë se një herë, parashikuar nga neni 134 paragrafi i dytë i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 01.03.2012, neni 18.

iv. Nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë.

- Rezulton të ketë qënë person nën hetim dhe gjykuar për kryerje të veprës penale: "Përvetësim të pasurisë private", në bazë të nenit 182/2 të Kodit Penal, nga Prokuroria dhe Gjykata e Rrethit Elbasan, më vitin 1977, i deklaruar fajtor dhe dënuar;

- "Plagosje të lehtë me dashje", në bazë të nenit 93/I-rë të Kodit Penal, nga Prokuroria dhe Gjykata e Rrethit Vlorë, në vitin 1984, i deklaruar fajtor dhe dënuar;

- "Agjitacionit dhe propogandës kundër shtetit", në bazë të nenit 55/1 dhe 31/a të Kodit Penal, nga Prokuroria dhe Gjykata e Rrethit Vlorë, i deklaruar fajtor dhe dënuar;

- "Kërcënimit serioz" të kryer në mënyrë vazhduese dhe "shqetësimit e besdisjes me anë të telefonit, në bazë të nenit 81 parag.2, neni 612 parag.2 dhe 660 të KP (Italian), nga Prokuroria dhe Gjykata e Shkallës së Parë Udine/ Itali, deklaruar fajtor dhe dënuar;

- "Vjedhjes", në bazë të nenit 628 parag.2 K.P.(Italian), nga nga Prokuroria dhe Gjykata e Zakonshme Pordenone/Itali.

- Rezulton të ketë qënë i arrestuar:

a. për veprën penale të agjitacionit dhe propogandës kundër shtetit, në bazë të nenit 55/1 dhe 31/a të Kodit Penal, nga Hetuesia e Rrethit Vlorë, më datë 14.11.1987. Ka ndenjur në paraburgim deri më datën 05.03.1988, kur ka marrë formë të prerë vendimi nr. 28, datë 25.02.1988 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për dënimin e tij me 6 (gjashtë) vjet heqje lirie;

b. për veprën penale të përvetësimit të pasurisë së tjetrit, në bazë të nenit 180/2 të Kodit Penal, nga Hetuesia e Rrethit Elbasan, më datën 11 dhjetor 1976. Ka ndenjur në paraburgim deri më



datën 24.01.1977, kur ka marrë formë të prerë vendimi nr. 10, datë 12.01.1977 i Gjykatës së Rrethit Elbasan, për dënimin e tij me 1 (një) vit heqje lirie;

c. për veprën penale të vjedhjes, parashikuar nga neni 628 prg 2 i K.Penal (italian), nga Karabineria në Pordenone / Itali, më datë 03.06.2018, vleftësuar e ligjshme nga Gjykata; Ka ndenjur në paraburgim deri më datë 05.07.2018, kur është ekzekutuar vendimi nr. 607/2018-Regj.Përgj. nr. 563/2018-RG NR nr. 2424/20, nxjerë më datën 04.07.2018, nga Gjykata e Zakonshme e Pordenone.

- Rezulton të këtë qënë i siguruar me masë shtrënguese të sigurisë personale arrest në burg: nga Gjykata Pordenone/ Itali, për veprën penale të vjedhjes, parashikuar nga neni 628 prg 2 i K. Penal (Italian), nga data 03.06.2018 deri më 05.07.2018 ;

- Nuk rezulton për udhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryrjen e ndonjë vepre penale prej tij;

- Rezulton që të jetë marrë masa e dëbimit nga shteti Italian:

- për 10 vjet deri më 2028 në bazë të Nenit 13 paragrafi 2 Dekreti Legjislativ 286/98 ekzekutuar në vitin 2004, në bazë të vendimit nr. 607/2018 Regj.Përgj. nr. 563/2018-RG NR nr. 2424/20, nxjerë më datën 04.07.2018, nga Gjykata e Zakonshme e Pordenone, si saksion alternative në zëvendësim të denimit me burg 1 vit e 3 muaj dhe 3000, 00 Euro gjobë, për veprën penale të "vjedhjes". Dëbim i realizuar në datë 05.07.2018, me fluturimin BV3626 nga aeroporti i Trevisos, sipas shënimit nga Kuestura Pordenone Zyra e Emigracionit prot.0019659;

- masë dëbimi e lëshuar nga Prefekti i Triestes më 16.2.13, si dhe në shkelje të udhërit të Kuestorit të Venecias të lëshuar më 06.11.2014, pas urdhërit të dëbimit të lëshuar nga Prefekti i të njëjtit qytet në të njëjtën datë, rregullisht të njoftuar të interesuarit, dhe të pa zbatuara prej tij, për këtë shkak dhe është dënuar dy herë me gjobën prej 10.000.00 Euro përveç shpenzimeve, nga Gjykata e Paqes së Padovas, me vendimin nr. 442/16, RG 233/17, datë 05.06.2017, marrë formë të prerë më 16.09.2017, dhe vendimin nr. 246/17, RG 419/16 e RG NR 168/16, datë 14 Korrik 2016, marrë formë të prerë më 01 Tetor 2016, në bazë të nenit 14 paragrafi 5-të i Dekretit Legjislativ nr. 286/98, i ndryshuar nga ligji 129/2011, sepse, pa arsye të justifikuara, ka qëndruar në territorin e Shtetit në kundërshtim me urdhërat sipërpërmendura.

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:



a) z. Ido Muharrem Pashaj, si kandidat i listës shumemërore të Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), qarku Fier në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, nuk ka marrë mandatin e deputetit. Subjekti zgjedhor, Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) referuar neneve 162 dhe 163 të Kodit Zgjedhor nuk ka fituar asnjë mandat. Në kushtet kur subjekti vetëdeklarues, kandidati i listës shumemërore të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), nuk do të mund të përfitojë mandat për këtë legjislaturë, Komisioneri nuk mund të shprehet për sa kohë ky subjekt, nuk gëzon statusin e deputetit dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar procedura administrative e verifikimit të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të neneve 10 dhe 11 të ligjit 138/2015, vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i verifikimit të thelluar. Gjetjet e rezultateve të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme do të bëjnë bazën e vlerësimit në kushtet kur subjekti do të ushtrojë të drejtën e kandidimit në të ardhmen për të marrë një prej funksioneve publike për të cilat do të jetë subjekt i verifikimit nga KQZ.

b) Bazuar në pikat 2 e 3, të nenit 90, dhe në nenin 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, është në diskrecionin e organit kompetent të deklarojë të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”



V E N D O S:

1. Të deklaroj të përfunduar procedurën administrative pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues z. Ido Muharrem Pashaj.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI

